

INSTITUTI I VETIZOLUAR

(VLERËSIM I SHOQËRISË CIVILE

PËR INSTITUTIN ALBANOLOGJIK TË

PRISHTINËS)

inTegra

 **KFOS**
Fundamenti Kosovian për Shqipëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society
Kosovska Fundacija za Otvoreno Društvo

INSTITUTI I VETIZOLUAR

(VLERËSIM I SHOQËRISË CIVILE

PËR INSTITUTIN ALBANOLOGJIK TË

PRISHTINËS)



**AUTOR:
SHKËLZEN GASHI**

**BOTUES:
KUSHTRIM KOLIQI**

**HULUMTUES:
ARDIT KIKA**

**REDAKTOR GJUHËSOR:
GAZMEND BËRLAJOLLI**

**DIZAJNI I KOPERTINËS DHE FAQOSJA:
BESART SLLAMNIKU**

**TIRAZHI:
1000 COPË**

**BOTUAR NGA:
© INTEGRA | WWW.NGO-INTEGRA.ORG**

**MBËSHTETUR NGA:
FONDACIONI I KOSOVËS PËR SHOQËRI TË HAPUR (KFOS) | WWW.KFOS.ORG**

**NËNTOR 2019
PRISHTINË**

RRETH PROJEKTIT

Projekti “Rishikim i shoqërisë civile dhe dialog publik për insitucionet e heshtura të Kosovës të financuara nga fondet publike” ka për qëllim të rishikojë dhe të reflektojë mbi punën e institucioneve specifike publike të Kosovës nëpërmjet hulumtimit dhe zhvillimit të aktiviteteve efektive, të orientuara drejt rezultateve që kanë në shënjestër nxitjen e dialogut publik për më shumë transparencë, llogaridhënie dhe qeverisje më të mirë të insitucioneve gjegjëse që financohen nga fondet publike. Fillimisht, institucioni në fokus të projektit është Instituti Albanologjik. Me anë të një shqyrtimi dhe analize sistematike e të pavarur të strukturës së brendshme, të funksionimit, të publikimeve, si dhe të rezultateve ose të arriturave të Institutit Albanologjik, ky projekt mëton të ofrojë të gjetura mbi aktivitetin e këtij institucioni dhe rekomandime konkrete për përmirësimin e performancës së tij. Ky grant është financuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS).

RRETH INTEGRA-S

Integra është organizatë e formuar nga një grup njerëzish të zotuar që të kontribuojnë për mëkëmbjen dhe zhvillimin e Kosovës dhe të rajonit. Puna e Integra-s udhëhiqet nga parimet e qeverisjes së mirë dhe të gëzimit të plotë të të drejtave të njeriut, pavarësisht nga etnia, raca, feja, gjinia, orientimi seksual ose përkatësia politike, të cilat janë thelbësore për ndërtimin e një Kosove demokratike dhe tolerante, plotësisht të integruar në bashkësinë evropiane.

www.ngo-integra.org | info@ngo-integra.org

Ky botim është realizuar me përkrahjen e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e autorit dhe e Organizatës Integra dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i KFOS-it.

PËRMBAJTJA

Hyrja	13
Historiku i Shkurtër i IA-së 15	
Qëllimi i IA-së	17
Mandati dhe Detyrat e Institutit Albanologjik	
Struktura organizative dhe vendimmarrja	19
Këshilli Drejtues Këshilli Shkencor Drejtori	
Projektet Shkencore	21
Libra Revista Konferenca/Simpoziume/Tryeza/Tubime Shkencore Botimi i kompletit të veprave të Rexhep Qosjes Botimi i kompletit të veprave të Anton Çettës	
Punonjësit shkencorë	25
Bashkëpunimi me institucionet e tjera	27
Bashkëpunimi me Akademinë e Studimeve Albanologjike në Tiranë Bashkëpunimi me Institutin e Trashëgimisë Kulturore të Shqiptarëve në Shkup Bashkëpunimi me institucionet e tjera shkencore, arsimore dhe kulturore Bashkëpunimi me institutet e tjera rajonale	
Financimi dhe Transparenca	31
Buxheti i Republikës së Kosovës Qiratë Donacionet dhe burimet e tjera	
Raportimi dhe Monitorimi	34
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë / Qeveria e Kosovës Komisioni Parlamentar për Arsim, Shkencë, Teknologji / Kuvendi i Kosovës	
Raporti me publikun	35



SHKURTESAT

BE – Bashkimi Europian

BA – Bachelor

FEK – Fjalori Enciklopedik i Kosovës

IA – Instituti Albanologjik

IOM – Internation Organization for Migration

ISSN – International Standard Serial Number

ITShKSh – Instituti për Trashëgiminë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve

KD – Këshilli Drejtues

KFOS – Kosova Foundation for Open Society

KSh – Këshilli Shkencor

KSAK – Krahina Socialiste Autonome e Kosovës

MA – Master

MAShT – Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë

ORCA – Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim

PhD – Doctor of Philosophy

QSA – Qendra e Studimeve Albanologjike

RSFJ – Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë

UP – Universiteti i Prishtinës

ERA - Hapësira Kërkimore Europiane

WOS – Web of Science

HYRJE

Ky publikim ka për qëllim parësor që të vërë në objektiv mandatin dhe detyrat e Institutit Albanologjik (IA), si dhe punën shkencore të tij, duke përfshirë këtu librat, revistat, tryezat dhe konferencat. Raporti po ashtu mëton të hedhë dritë mbi mënyrën si është bërë përzgjedhja e punonjësve dhe e bashkëpunëtorëve të IA-së, duke shqyrtuar kriterin profesional, politik, etnik e gjinor, pastaj integritetin akademik të tyre, financimet e këtij instituti dhe transparencën e tij. Veç këtyre, raporti heton edhe nivelin e bashkëpunimit të IA-së me institucionet e tjera shkencore e kërkimore, e në fund edhe raportimin e këtij institucioni në Qeverinë, përkatësisht në Kuvendin e Kosovës.

Për t'i arritur qëllimet e lartpërmendura, në radhë të parë analizuam kornizën ligjore për IA-në që nga themelimi më 1953 e deri më sot, kur u miratua ligji i fundit për këtë institucion, për t'i shqyrtuar më pas statutet, rregulloret e dokumentet e tjera relevante ligjore që lidhen me IA-në. Pas këtyre i shqyrtuam edhe botimet e IA-së – librat, revistat dhe publikimet e tryezave e të konferencave. Më tej, analizuam biografitë e të gjithë punonjësve të IA-së për të parë përkatësinë etnike, gjinore e politike të secilit, pastaj studimet e niveleve BA, MA e PhD, e mbi të gjitha publikimet e tyre në revista të mirëfillta akademike ndërkombëtare. Lidhur me financimin dhe transparencën e IA-së hulumtuam buxhetet e Kosovës që nga viti 2012, raportet e auditorit dhe kontratat e qirave të hapësirave të IA-së. Sa i takon bashkëpunimit të IA-së me institucionet e tjera, hetuam nëse ka ndonjë rezultat konkret nga marrëveshjet, memorandumet e protokollet e bashkëpunimit. Në fund, për raportimin e IA-së në Qeveri/Kuvend, kërkuam informata nga Komisioni për Arsim, Shkencë dhe Teknologji i Kuvendit të Kosovës.

Për të gjitha çështjet e mësipërme, shqyrtuam edhe shumë artikuj, intervista, letra e reagime të ndryshme, të publikuara në medie të ndryshme (gazeta, radio, televizione e portale), qoftë nga anëtarë të IA-së, qoftë nga kritikë e kundërshtarë të këtij institucioni. Për më shumë, i intervistuam edhe drejtuesit e IA-së. Për çështjet në fjalë bashkëbiseduam edhe me profesorë universitarë, pjesëtarë të shoqërisë civile, gazetarë, e kështu me radhë. Në fund fare, organizuam edhe një grup fokusi me pjesëtarë të shoqërisë civile, të cilët na dhanë shumë këshilla, sugjerime, vërejtje, komente, propozime e rekomandime të vlefshme.

Shfrytëzojmë rastin që t'i falënderojmë të gjithë ata që ndihmuan për këtë publikim. Në radhë të parë, të gjithë punonjësit e IA-së që na ndihmuan në forma të ndryshme për realizimin e këtij e raporti, e me theks të veçantë: drejtorin Hysen Matoshi, sekretarin shkencor Lulëzim Lajçi, si dhe sekretarin Sylë Kasumaj për intervistat, si dhe për dokumentet e publikimet e IA-së; pastaj pjesëtarët e grupit të fokusit për kontributet e tyre: Vjollcë Krasniqi, Rebeka Qena, Nora Ahmetaj, Florie Xhemajli, Xhevahir Kolgjini, Shkumbin Brestovci, Imer Mushkolaj, Arbër Vokri, Besnik Boletini dhe Rron Gjinovci. Falënderojmë edhe Organizatën për Rritjen e Cilësisë në Arsim (ORCA) për ndihmën me hulumtimin e publikimeve në revista akademike të punonjësve të IA-së.



HISTORIK I SHKURTËR I IA-SË

IA u themelua më 1 qershor 1953 në Prishtinë nga Qarku Autonom i Kosovës dhe Metohisë¹, me një vendim të posaçëm gjysmëfaqësh, në të cilin thuhej se IA «...ka për detyrë të studiojë gjuhën, historinë dhe letërsinë shqiptare ; të bashkëpunojë me institute dhe institucione të tjera që merren me studimin e kulturës shqiptare²; të nxjerrë raporte vjetore mbi rezultatet e arritura dhe, nëse është e nevojshme, botime të tjera në fushën e punës së vet».³ Në këtë kohë, IA kishte gjithsej katër punonjës: Ilhami Nimani, Selman Riza, Mehdi Bardhi dhe Ali Rexha; si dhe disa bashkëpunëtorë të jashtëm: Anton Çetta, Esad Mekuli, Hasan Mekuli, Hivzi Sylejmani e Kadri Halimi.⁴

Pas dy vjetësh, më 1955, IA u mbyll nga autoritetet jugosllave. Ilhami Nimani u dërgua me punë në Beograd, ndërkaq Selman Riza u deportua në Shqipëri dhe iu morën disa dorëshkrime nga UDB-ja.⁵ Disa muaj pas Plenumit të Brionëve, më 28 shkurt 1967,⁶ IA u rithemelua nga Fehmi Agani, Rexhep Qosja dhe Zekeria Cana. Për 10 vjet IA funksionoi në objektin e ish-kazermës ushtarake, ndërkaq në vitin 1977 u vendos në godinën moderne, të ndërtuar enkas për këtë institucion,⁷ ku ndodhet edhe sot.⁸

Puna kërkimore e shkencore e IA-së e ka në fokus gjuhën, letërsinë, folklorin, etnologjinë dhe historinë e shqiptarëve.⁹ Botimet më të njohura të IA-së janë revista 'Gjurmime albanologjike', e cila botohet që nga viti 1968,¹⁰ me seri të veçanta: filologji, histori dhe folklor e etnologji, si dhe revista 'Gjuha shqipe', e cila botohet që nga viti 1982,¹¹ e që trajton çështje nga praktika dhe kultura e gjuhës.¹² Biblioteka e IA-së mban mbi 20 mijë libra e 17 mijë revista të ndryshme.¹³

Në periudhën prej fundit të viteve të 1960-ta e deri në fund të viteve të 1980-ta, IA kishte detyra jo vetëm shkencore, por edhe politike, ngaqë shumë punonjës shkencorë të këtij institucioni u angazhuan publikisht përmes shkrimeve, intervistave, reagimeve e polemikave kundër politikës diskriminuese serbe ndaj shqiptarëve. Në fund të viteve të 1980-ta Serbia nisi ndryshimet kushtetuese për heqjen e autonomisë së Kosovës, duke shkelur në mënyrë drastike të drejtat themelore të shqiptarëve të Kosovës. Më vonë, në fillim të vitit 1990, Serbia ndërpreu financimin për IA-në¹⁴, mirëpo puna vazhdoi me mbështetje financiare modeste për punonjësit e IA-së prej institucioneve të Qeverisë së Republikës së Kosovës në ekzil, si dhe me ndihmat e Shoqatës Humanitare 'Nëna Terezë'.¹⁵

Më 8 mars 1994, persona civilë të armatosur i nxorën me forcë punonjësit e IA-së nga objekti, duke u thirrur në një vendim që në dhjetor 1993 e kishte marrë shefi i Qarkut të Kosovës, Miloš Simović.¹⁶ Sipas Sadri Fetiut, drejtor i IA-së në vitet 1991-2007, pak ditë para hyrjes në fuqi të vendimit, punonjësit e IA-së i bartën dokumentet dhe librat e IA-së në shtëpitë e Sebush Dërmakut, Jahir Ahmetit, Nazmi Zekës e Zenel Kastratit.¹⁷ IA u detyrua ta zhvillonte veprimtarinë në një shtëpi në pronësi të LDK-së në lagjen Kodra e Diellit në Prishtinë. Fetiut thotë se vendimi për këtë ishte i udhëheqësit të shqiptarëve të Kosovës, Ibrahim Rugova, i cili, deri para se t'i hynte politikës më 1990, ishte edhe vetë punonjës shkencor i IA-së.¹⁸

IA e vazhdoi punën në shtëpi private deri në prill të vitit 1998, kur filloi të zbatohet Marrëveshja për Arsim mes Presidentit të Serbisë, Slobodan Milošević, si dhe udhëheqësit të shqiptarëve të Kosovës, Ibrahim Rugova, e cila parashihte që autoritetet serbe ta lejonin kthimin e studentëve dhe të profesorëve shqiptarë në institucionet edukative.¹⁹ Gjatë kohës së bombardimeve të NATO-s, objekti i IA-së u përdor si vendstrehim i forcave serbe. Pas hyrjes së trupave të NATO-s në Kosovë, në qershor të vitit 1999, IA e rifilloi punën në ndërtesën e vet.²⁰

1. QËLLIMI I IA-SË

MANDATI DHE DETYRAT E IA-SË

Ligji për Veprimtari Kërkimore Shkencore, i miratuar në vitin 2013, e përkufizon IA-në si institucion shkencor që ushtron veprimtari kërkimore-shkencore.²¹ Sipas këtij ligji, IA duhet të kujdeset për ngritjen e kapaciteteve kërkimore-shkencore, ta organizojë dhe ta përparojë veprimtarinë e publikimeve dhe të informimit kërkimor-shkencor, të bashkëpunojë me institucionet kërkimore-shkencore të vendit e të botës, si dhe ta promovojë integrimin e shkencës së Kosovës në Hapësirën Kërkimore Europiane (ERA).²²

Statuti i IA-së, i miratuar nga Këshilli Drejtues i këtij instituti më 27 prill 2015, përcakton se veprimtaria e IA-së është e përqendruar në punën kërkimore-shkencore nga fusha e shkencave albanologjike dhe e kulturës shqiptare: gjuhë e letërsi shqipe, folklor e kulturë popullore shqiptare, muzikologji, etnologji dhe histori shqiptare.²³

Statuti i IA-së thotë se detyrat e IA-së janë që t'i bëjë publike rezultatet e kërkimeve shkencore dhe pasurinë shpirtërore e materiale të shqiptarëve, si dhe të krijojë kushte për formimin dhe ngritjen e kuadrit të nevojshëm shkencor, brenda e jashtë Kosovës, me qëllim që t'i zbatojë detyrat kërkimore-shkencore dhe t'i afirmojë studimet albanologjike. Për këtë, sipas Statutit, IA duhet:

- të realizojë projekte të ndryshme kërkimore-shkencore: monografi, revista shkencore, studime dhe punime të tjera në shqip ose në gjuhë të tjera nga fushat e IA-së;
- ta vjelë e ta përpunojë lëndën gjuhësore, letrare, folklorike, etnomuzikologjike, arkeologjike, historike, etnologjike, që ka vlerë për studimet albanologjike;
- ta publikojë punën e vet shkencore nëpërmjet botimeve periodike dhe veprave të veçanta;
- të botojë studime të autorëve shqiptarë dhe të huaj, që janë me interes për albanologjinë;
- t'i regjistrojë, t'i mbledhë dhe t'i studiojë gjetjet dhe monumentet kulturore, pastaj lëndën arkivore dhe dokumentare, të cilat i konsideron të vlefshme për punën kërkimore-shkencore dhe për kulturën e shqiptarëve në përgjithësi, t'i kërkojë dhe t'i ruajë ato nëse e sheh të nevojshme, sidomos kur janë të pambrojtura ose kur janë në kuadrin e institucioneve të tjera;
- të bashkëpunojë me institucione e individë që bëjnë punë të ngjashme brenda e jashtë vendit;
- të organizojë tribuna, tryeza, sesione, simpoziume, konferenca dhe kongrese

- shkencore, që kanë për qëllim të shtrojnë, të shtjellojnë dhe të zgjidhin probleme nga albanologjia;
- ta organizojë punën në bibliotekën e vet të specializuar, duke mbledhur edhe materiale të tjera, që ua ofron për shfrytëzim individëve dhe institucioneve të interesuara;
 - ta organizojë punën në arkivin shkencor, duke mbledhur e ruajtur materiale nga terreni;
 - të zhvillojë forma të ndryshme të popullarizimit të punës së vet shkencore, duke organizuar dhe duke nxitur interesim për fushat që studion dhe për rezultatet e arritura;

IA realizon projekte të ndryshme kërkimore-shkencore dhe publikon punën e vet shkencore nëpërmjet botimeve periodike dhe veprave të veçanta – monografive, revistave shkencore, studimeve dhe punimeve të tjera – por pa recensione të tipit 'peer review' dhe vetëm në gjuhën shqipe. Po ashtu, IA boton studime të autorëve shqiptarë që janë me interes për albanologjinë, por deri më tani nuk e ka publikuar asnjë studim të ndonjë autori ndërkombëtar për albanologjinë.

IA bashkëpunon me institucione e individë që bëjnë punë të ngjashme brenda e jashtë vendit, por me gjithë memorandumet dhe protokollat e bashkëpunimit, nuk ka asnjë publikim të përbashkët, madje rezultati i vetëm i memorandumëve dhe i protokolleve është pjesëmarrja e anëtarëve të instituteve respektive në publikimet ose konferencat/simpoziumet/tryezat/tubimet shkencore të njëri-tjetrit.

IA organizon edhe tribuna, tryeza, sesione, simpoziume, konferenca dhe kongrese shkencore, që kanë për qëllim t'i shtrojnë, t'i shtjellojnë dhe t'i zgjidhin problemet nga fusha e albanologjisë, por në këto konferenca, simpoziume, tryeza e tubime shkencore të organizuara nga IA shumica dërrmuese e pjesëmarrësve janë shqiptarë. Të gjitha publikimet nga këto konferenca, simpoziume, tryeza e tubime shkencore botohen vetëm në shqip dhe pa 'peer review'.

Të gjitha projektet e IA-së janë projekte kombëtare, që do të thotë IA nuk ka asnjë projekt ndërkombëtar.

Sa mund të thuhet që IA zhvillon forma të ndryshme të popullarizimit të punës së vet shkencore, kur nuk ka Zyrë për Marrëdhënie me Publikun e as zëdhënës dhe, mbi të gjitha, faqen zyrtare në internet e ka të pastrukturuar, të papërditësuar dhe vetëm në gjuhën shqipe, pa asnjë material të vetëm në gjuhën angleze.

2. STRUKTURA ORGANIZATIVE

IA ndahet në sektorin shkencor dhe atë administrativ.²⁴ Sektori shkencor ndahet në 5 degë:²⁵ Histori, Folklor, Gjuhësi, Letërsi dhe Etnologji.²⁶ Ndërkaq, sektori administrativ përbëhet nga sekretari, zyrtari i financave, zyrtari i teknologjisë informative (IT), bibliotekistja, arkivistja, radhitëset kompjuterike, pastrueset, sigurimi dhe centralisti.²⁷

KËSHILLI DREJTUES - KD

Këshilli Drejtues (KD) është organ kolegjal i qeverisjes së IA-së që përbëhet nga 5 anëtarë, 3 nga të cilët caktohen prej Këshillit Shkencor të IA-së (drejtori sipas ligjit, si dhe sekretari sipas statutit, kanë pozita të garantuara në KD). Dy anëtarë të tjerë me tituj shkencorë emërohen nga MASHT-i.²⁸ Ndonëse ligjërisht janë 5 anëtarë të KD-së, faktikisht janë shtatë: Hysen Matoshi, drejtor, Lulëzim Lajçi, sekretar shkencor, Leontina Musa, drejtuese e degës së folklorit, Memli Krasniqi, drejtues i degës së historisë, Qemal Murati, drejtues i degës së gjuhësisë, si dhe nga MASHT-i: Ismail Syla, këshilltar politik i Presidentit të Kosovës²⁹ dhe Sali Bashota, i cili dha dorëheqje rishtazi ngaqë u zgjodh anëtar i Bordit të RTK-së^{30,31}

KD nxjerr aktet nënligjore që e rregullojnë punën e IA-së, organizon e krijon kushte për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore të IA-së, si dhe, në bazë të propozimeve të degëve të IA-së, miraton planin e punës shkencore dhe planin e veprimtarisë botuese të IA-së.³² Po ashtu, KD miraton planin financiar, raportin e punës, si dhe raportin financiar.³³ KD zgjedh dhe shkarkon drejtorin, sekretarin shkencor dhe sekretarin e IA-së.³⁴ KD udhëhiqet nga drejtori.³⁵

KËSHILLI SHKENCOR - KSH

Këshilli Shkencor (KSh) i IA-së është organ vendimmarrës në sferën shkencore dhe profesionale³⁶ dhe përbëhet nga të gjithë punonjësit shkencorë të IA-së që mbajnë së paku titullin "bashkëpunëtor shkencor".³⁷ Kompetencat e KSh-së janë që të vendosë për çështjet shkencore e profesionale, ta propozojë planin e punës kërkimore-shkencore dhe të veprimtarisë botuese të IA-së, si dhe ta shqyrtojë raportin e punës kërkimore-shkencore të IA-së.³⁸ Po ashtu, KSh i cakton komisionet dhe zhvillon procedurën e zgjedhjes për tituj shkencorë e për tituj hulumtues, si dhe kujdeset për aftësimin e kuadrove shkencore dhe profesionale. Përveç këtyre, KSh zgjedh anëtarët e KD-së nga shefat e degëve, si dhe në bazë të propozimeve të degëve zgjedh kryeredaktorët dhe anëtarët e redaksive të revistave dhe të botimeve të veçanta të IA-së, por edhe propozon kandidatët për drejtor dhe për sekretar shkencor të IA-së.³⁹ Mbledhjet e KSh-së i thërret dhe i kryeson Drejtori i IA-së.⁴⁰

DREJTORI

Drejtori është përgjegjës për ligjshmërinë e vendimeve të IA-së. Konkursi për drejtor të IA-së është publik. Ai propozohet nga një komision i emëruar nga KSh dhe emërohet ose shkarkohet nga KD.⁴¹ Sipas ligjit, drejtori, përveç që e drejton IA-në, e kryeson edhe KD-në⁴² edhe KSh-në⁴³ dhe, për më shumë, nuk ka kurrfarë kufizimesh ligjore a statutare për numrin e mandateve të tij.

3. PROJEKTET SHKENCORE

A. LIBRAT

Në periudhën 1967-2015 në fushat: histori, folklor e etnologji, gjuhësi dhe letërsi, IA ka botuar 334 botime të veçanta me gjithsej 170 autorë, prej të cilave 122 botime nga autorë burra, 20 nga gra dhe 36 nga grupe autorësh. Të gjitha botimet janë të autorëve shqiptarë dhe që të gjitha në gjuhën shqipe e me tematikë për historinë, folklorin, etnologjinë, gjuhësinë dhe letërsinë shqiptare. IA ka vetëm një botim katërvëllimësh të viteve të 1970-ta prej një autori të huaj në gjuhën serbe dhe vetëm dy autorë të huaj të përkthyer nga anglishtja në gjuhën shqipe në vitet 2011 e 2012.

Dega e Historisë ka gjithsej 58 botime të 35 autorëve (29 nga burra, 4 nga gra e 2 nga grupe autorësh). Të gjitha botimet janë të autorëve shqiptarë, në gjuhën shqipe e me tematikë për shqiptarët. Në kuadër të këtij seksioni nuk ka asnjë botim me autor të huaj dhe asnjë botim në gjuhë të huaj.

Dega e Folklorit dhe e Etnologjisë ka gjithsej 115 botime nga 54 autorë (36 nga burra, 8 nga gra, dhe 18 nga grupe autorësh). Të gjitha botimet janë të autorëve shqiptarë, në gjuhën shqipe e me tematikë për shqiptarët. Në kuadër të këtij seksioni nuk ka asnjë botim me autor të huaj dhe asnjë botim në gjuhë të huaj.

Dega e Gjuhësisë ka gjithsej 75 botime prej 48 autorëve (32 botime nga burra, 3 nga gra e 13 nga grupe autorësh). Të gjitha botimet janë të autorëve shqiptarë, në gjuhën shqipe e me tematikë për shqiptarët. Në kuadër të këtij seksioni nuk ka asnjë botim me autor të huaj dhe asnjë botim në gjuhë të huaj.

Dega e Letërsisë ka gjithsej 86 botime të 33 autorëve (25 nga burra, 5 nga gra e 3 nga grupe autorësh). Të gjitha botimet janë të autorëve shqiptarë dhe në gjuhën shqipe. Në kuadër të këtij seksioni nuk ka asnjë botim me autor të huaj dhe asnjë botim në gjuhë të huaj.^{44 45}

B. REVISTAT

«Gjurmime albanologjike» është revistë që del çdo vit që nga viti 1968 në tri seri: seria e shkencave filologjike, seria e shkencave historike dhe seria për folklor e etnologji. Në këtë revistë deri në vitin 2012 kanë publikuar studime e artikuj gjithsej 490 autorë, prej të cilëve 400 shqiptarë e 90 të huaj, kryesisht nga vendet përreth Kosovës, që kanë botuar gjatë viteve të 1970-ta, por edhe albanologë e studiues të huaj që kanë botuar

kryesisht në këto dy dekadat e fundit. Struktura gjinore e autorëve është 419 burra e 71 gra. E rëndësishme është se të gjitha punimet në këtë revistë janë në gjuhën shqipe, pa përmbledhje në anglisht. Revista ka gjithsej 48 numra. Numri i fundit është botuar në vitin 2018.⁴⁶

«Gjuha shqipe» është revistë që boton punime nga fusha e gjuhësisë. Numri i parë i saj u botua në vitin 1983. Deri në vitin 1989 janë botuar nga tre numra të kësaj reviste për çdo vit. Për shkak të gjendjes nën okupim, në vitin 1990 u botua vetëm një numër, pastaj një numër në vitin 1997 dhe në vitin 1998 dy numra. Pas luftës në Kosovë (1998-1999), revista filloi të botohet çdo vit, e që nga viti 2004 deri në vitin 2015 botoheshin nga tre numra të kësaj reviste në vit. Deri më tani janë botuar gjithsej 74 numra. Të gjithë numrat janë në shqip, pa abstrakte në anglisht ose në ndonjë gjuhë tjetër. Janë gjithsej 978 publikime, prej tyre 24 publikime nga autorë të huaj, të tjerët nga shqiptarë; 841 publikime janë të autorëve burra, e 137 janë publikime të autoreve gra.⁴⁷

«Albanologji» është revistë në të cilën publikohen punimet e autorëve që marrin pjesë te “Java e Albanologjisë”, e cila organizohet çdo vit që nga viti 2011. Deri më tani janë botuar gjithsej 16 numra. Numri i fundit është botuar më 2016. Nga 687 publikime në këtë revistë, 488 janë burra, 199 janë gra, 678 janë të autorëve shqiptarë, e vetëm 9 janë të autorëve të huaj. Po ashtu, të gjitha kontributet janë në gjuhën shqipe dhe nuk kanë përmbledhje të shkurtra në anglisht.⁴⁸

IA ka gjithsej tri revista në të cilat botojnë kryesisht punonjësit e IA-së. A i përmbushin këto revista standardet teknike dhe cilësore të një reviste serioze, a janë të qasshme për të gjithë komunitetin në çdo kohë, a kanë ISSN, a janë të indeksuara në databaza serioze dhe mbi të gjitha, a kanë ‘peer review’? Qasja në revista zakonisht sigurohet përmes indeksimit të tyre në databazat serioze. Kriter i domosdoshëm teknik për indeksimin në databaza serioze është që revistat të kenë ISSN, kod i njohur ndërkombëtarisht që identifikon publikimet serike, i cili nuk është kriter profesional, por vetëm Teknik.⁴⁹ Për t’u indeksuar në databaza serioze, siç janë SCOPUS, WOS, e të tjera me radhë, është e domosdoshme që revistat ta praktikojnë procesin ‘peer review’.

Qëllimi i recensimit të tipit ‘peer review’ është që artikujt e publikuar t’i përmbushin standardet e cilësisë dhe të vlefshmërisë shkencore, prandaj është e rëndësishme që të sqarohen hapat e këtij procesi:

1. Redaktori i revistës vlerëson nëse janë përmbushur kriteret nga autori i artikullit.
2. Nëse artikulli ka përmbushur kriteret, atëherë redaktori i fton dy-tre ekspertë të lëmit që ta shqyrtojnë artikullin.
3. Më pas, ekspertët përpilojnë një raport me komente mbi artikullin, të cilin

- redaktori ia kthen autorit për përmirësim.
4. Pasi t'i ketë bërë përmirësimet e sugjeruara, autori ia ridorëzon artikullin për vlerësim redaktorit.
 5. Redaktori merr edhe njëherë mendimet e ekspertëve dhe vendos nëse artikulli ka përmbushur të gjitha standardet (teknike e shkencore) për publikim.
 6. Në artikujt e revistave që e praktikojnë procesin e recensimit 'peer review', figuron emri i redaktorit që e ka përcjellë gjithë procesin.⁵⁰

Prej këtyre pesë revistave të IA-së, asnjëra nuk ka ISSN (kod të pranuar e të njohur ndërkombëtarisht për publikimet serike), që është kriter teknik për revistat. Po ashtu, asnjëra prej këtyre pesë revistave nuk i ka publikimet në internet e të qasshme për publikun, që po ashtu është kriter teknik për revistat.

Përgjegjësit e të gjitha revistave thonë se kanë 'peer review', mirëpo ato nuk i përmbushin kriteret e kërkuara për një revistë me 'peer review':

- a) Asnjëra prej këtyre revistave nuk gjendet në databazat serioze ku indeksohen revistat me 'peer review', si: SCOPUS, WOS, ose në ndonjë tjetër e fushës së ngushtë.
- b) Në asnjërin prej artikujve të këtyre revistave nuk figuron emri i redaktorit që e ka përcjellë procesin e vlerësimit të artikullit;
- c) Në asnjërën prej këtyre revistave nuk ka të dhëna për datën e dërgimit të punimit në revistë dhe datën e pranimit të punimit nga redaktori i revistës.

Të gjithë librat, revistat dhe publikimet e tjera të IA-së, sipas drejtuesve të IA-së, u shpërndahen të gjitha bibliotekave dhe institucioneve të tjera relevante në Republikën e Kosovës. Po ashtu, publikimet e IA-së janë në shitje nëpër librari të ndryshme, megjithëse, sipas drejtuesve të IA-së, ato kryesisht jepen falas.

C. KONFERENCA/SIMPOZIUME/TRYEZA/TUBIME SHKENCORE

IA nuk posedon të dhëna të sakta për konferencat, simpoziumet, tryezat e tubimet shkencore të organizuara nga seksionet e IA-së – Histori, Folklor e Etnologji, Gjuhësi, dhe Letërsi.⁵¹ Nëpër konferencat, simpoziumet, tryezat e tubimet shkencore të IA-së, shumica dërrmuese e pjesëmarrësve janë shqiptarë, e tek-tuk merr pjesë edhe ndonjë i huaj. Instituti Albanologjik e konsideron konferencën disaditore «Java e Albanologjisë» si organizimin kryesor të përvitshëm. Fjalët e pjesëmarrësve, në bazë të vendimit të një redaksie të përbërë nga punonjësit shkencorë të IA-së, botohen në revistën «Albanologji». Organizimi kryesor ndërkombëtar, i udhëhequr nga punonjësit e Degës së Folklorit, ka qenë konferenca vjetore e Komisionit Ndërkombëtar të Baladës, e mbajtur në vitin 2015.⁵²

D. BOTIMI I KOMPLETIT TË VEPRAVE TË REXHEP QOSJES

Në vitin 2009, Instituti Albanologjik i drejtoi kërkesë MASHT-it për mbështetje financiare të botimit të veprës së plotë të akademik Rexhep Qosjes. Kërkesa u miratua nga MASHT-i më 2010 dhe në të njëjtin vit, nën përkujdesjen e Këshillit Redaktues të përbërë nga Hysen Matoshi, Jorgo Bullo, Shefkije Islamaj, Agim Vinca dhe Arben Hoxha, u përgatit për shtyp kompleti i kësaj vepre me 29 vëllime e me rreth 13 mijë faqe gjithsej. Vlera e projektit ishte 198 mijë euro, prej të cilave 77.431 euro u shfrytëzuan për përgatitjen dhe shtypjen e kompletit, kurse 120.569 euro u ndanë si honorar për autorin, ndonëse shumica e këtyre veprave janë ribotime.⁵³ Në pyetjen tonë se pse ka qenë i rëndësishëm botimi i këtij kompleti, nuk morëm kurrfarë përgjigje.

E. BOTIMI I KOMPLETIT TË VEPRAVE TË ANTON ÇETTËS

Në vitin 2015, Dega e Folklorit e Institutit Albanologjik, në bashkëpunim me familjen e Anton Çettës, morën vendim për botimin e veprës së plotë të tij, nën përkujdesjen e një redaksie të përbërë nga Leontina Gega-Musa, Fazli Syla, Anton Berisha, Myzafere Mustafa, Zymer Neziri e Arbnora Dushi, si dhe të një Këshilli Botues të përbërë nga Hysen Matoshi, Leontina Gega-Musa, Lulëzim Lajçi, si dhe dy vajzat e Anton Çettës, Donika e Agata. Kompleti i veprave të Anton Çettës, i përbërë nga 13 vëllime, u përgatit nga IA për shtyp dhe u dorëzua për botim në MASHT në vitin 2018, por deri më sot nuk është botuar për arsye që nuk dihen. Projekti është paraparë të kushtojë 48 mijë euro (tirazhi është paraparë që t'i jepet familjes) dhe si komplet do të botohet për herë të parë, megjithëse shumica e veprave janë ribotime.⁵⁴ Në pyetjen tonë se pse ka qenë i rëndësishëm botimi i këtij kompleti, nuk morëm kurrfarë përgjigje.

4. PUNONJËSIT SHKENCORË

Nga gjithsej 36 punonjës shkencorë të IA-së, studimet në nivelin BA 31 i kanë i kanë të përfunduara në Universitetin e Prishtinës, tre në Universitetin e Zagrebit, një në Universitetin e Tiranës dhe një në Universitetin e Shkupit. Studimet e nivelin MA 28 i kanë përfunduar në Prishtinë, gjashtë në Tiranë, një në Zagreb, një në Lyon. Nga 25 punonjës me PhD, 12 e kanë kryer në Prishtinë, tetë në Tiranë, një në Tetovë, një në Shkup, një në Zagreb dhe një në Vjenë. Është me rëndësi të theksohet se nga 36 punonjës të IA-së, 31 i kanë të gjitha nivelet e studimeve të përfunduara nëpër universitetet shqiptare, e vetëm pesë e kanë përfunduar të paktën njërin nivel në universitete në gjuhë të huaja.⁵⁵

Në bazë të Ligjit për veprimtari kërkimore-shkencore, për t'u zgjedhur në titullin hulumtues nuk kërkohen fare publikime, e për hulumtues të pavarur kërkohen punime të publikuara në revista shkencore, por nuk specifikohet sa punime dhe në çfarë revistash shkencore.⁵⁶ Ndërkaq, për titullin bashkëpunëtor shkencor kërkohet së paku një punim shkencor në ndonjë revistë relevante ndërkombëtare në kuadër të lëmit; për bashkëpunëtor të lartë shkencor, kërkohen së paku tri punime shkencore në revistat relevante ndërkombëtare në kuadër të lëmit, kurse për këshilltar shkencor kërkohen së paku pesë punime shkencore në revistat relevante ndërkombëtare në kuadër të lëmit.⁵⁷

Lartësia e pagës për punonjësit shkencorë të IA-së bazohet në lartësinë e pagave të profesorëve të rregullt dhe të asocuar universitarë.⁵⁸ Ndërsa, duke u bazuar në llogaritjet tona nga Ligji i ri për Pagat (vlera monetare dhe koeficientët përkatës) paga bazë për hulumtues është 740 euro, hulumtues të pavarur 836 euro, bashkëpunëtor shkencor 1218 euro, bashkëpunëtor të lartë shkencor 1362 euro dhe këshilltar shkencor 1505 euro.⁵⁹

Nga 36 punonjës shkencorë të IA-së, shumica (31) i kanë të publikuara CV-të në faqen e internetit të IA-së, por nuk i kanë të përditësuara me publikimet nëpër revista akademike vendore e ndërkombëtare. Meqë IA na i ofroi CV-të e përditësuara të 36 punonjësve shkencorë të IA-së,⁶⁰ kërkua në platformat 'Scopus' dhe 'Web of Science' për të parë nëse kanë publikime nëpër revista akademike ndërkombëtare. Nga kërkimi i titujve të punimeve, i numrave të ISSN-së dhe i emrave të publikuesve në të dyja platformat, rezultoi se prej 36 punonjësve të IA-së, asnjëri nuk ka punime të publikuara në revista akademike ndërkombëtare të listuara në këto platforma.

Nga 36 punonjës të IA-së, vetëm dy kanë qenë të përfshirë në garën zgjedhore: Sejdi Gashi në vitin 2007 për Partinë Reformiste ORA,⁶¹ si dhe Bashkim Lajçi në vitin 2017 për Lëvizjen Vetëvendosje.⁶² Po ashtu, në Këshillin Drejtues të IA-së, Ismail Sylja, njëri nga dy anëtarët e caktuar nga MASHT-i, është këshilltar politik i Presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi.⁶³

Sa i takon kriterit gjinor, IA ka 36 punonjës të rregullt, prej të cilëve 25 burra e 11 gra, ndërkaq nga stafi administrativ, 4 janë burra e 4 gra. Lidhur me kriterin etnik, prej 36 punonjësve, që të gjithë janë shqiptarë.

5. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET E TJERA

BASHKËPUNIMI ME AKADEMINË E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE NË TIRANË

Gjatë kësaj dekade, në kornizat e programeve të veçanta të punës, IA ka pasur bashkëpunim me ASA-n (Akademinë e Studimeve Albanologjike), që dikur njihej si Qendra e Studimeve Albanologjike. Janë bashkorganizuar shtatë konferenca e tribuna shkencore, si dhe janë publikuar dy botime të përbashkëta: "Kujtesa kolektive: Dëshmi dhe ngjarje (1944-1966)" dhe "Shqiptarët në historinë e Ballkanit Perëndimor (1689-1839)".

Më 7 qershor 2018, IA ka nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi me ASA-n dhe janë pajtuar që:

- ta formojnë një Këshill Koordinues i cili do të takohej së paku dy herë në vit;
- ta hartojnë strategjinë studimore dhe planin e përbashkët kërkimor-shkencor;
- të këmbëjnë botime e materiale;
- të bashkëpunojnë në kualifikimin e kuadrove;
- të kenë pjesëmarrje të ndërsjellë në redaksitë e revistave shkencore 'Gjurmime Albanologjike' dhe 'Studime historike'; si dhe
- t'u japin hapësirë për botim studiuesve të të dyja instituteve.⁶⁴

Sipas Drejtorit të IA-së, Hysen Matoshit, ngritja e trupave të paraparë sipas këtij memorandumi, pastaj hartimi i strategjisë dhe organizimi i aktiviteteve të përbashkëta nuk janë realizuar për shkak të (mos)planifikimeve buxhetore, si dhe duke qenë se gjithë këta hapa kushtëzohen edhe nga ndarja e fondeve nga të dy subjektet bashkëpunuese, sepse nuk mund të ketë bashkëpunim me financim të vetëm njëjës palë. Më tej, Matoshi shton se deri më tani ka pasur raste të botimit të punimeve studimore të punonjësve të të dyja institucioneve nëpër revistat përkatëse shkencore, si dhe këmbim të botimeve mbi baza të rregullta, pjesëmarrje të ndërsjellë në redaksitë e revistave shkencore – një anëtar nga ASA është në redaksinë e 'Gjurmime albanologjike' dhe një nga IA në redaksinë e 'Studime historike'. Sa i përket kualifikimit të kuadrove, meqë është akredituar për studimet e doktoratës, ASA ka pranuar gjashtë doktorantë nga radhët e punonjësve të IA-së.⁶⁵

BASHKËPUNIMI ME INSTITUTIN E TRASHËGIMISË KULTURORE TË SHQIPTARËVE NË SHKUP

Më 24 shkurt 2009 IA ka nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi edhe me Institutin për Trashëgiminë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve (ITShKSh) në Shkup, që parashihte:

- pjesëmarrjen e studiuesve në veprimtaritë shkencore të rëndësishme që organizohen dhe që paraqesin interes për palën tjetër (projekte kërkimore-shkencore, konferenca shkencore, sesione, simpoziume, etj.);
- hulumtime të përbashkëta shkencore në terren;
- organizimin e ligjëratave shkencore nga fusha të ndryshme të albanologjisë;
- botimin e ndërsjellë të studimeve të palës tjetër në organet përkatëse shkencore;
- këmbimin e përvojave të studiuesve (ligjëruesve) ndërmjet dy institucioneve; si dhe
- shkëmbimin e literaturës dhe të informacionit shkencor me interes për secilën palë (revistat dhe botimet e tjera shkencore me nga tri kopje si dhe materialet e fotokopjuara ose të mikrofilmuara nga arkivat e tyre shkencore, ose të botimeve të rralla).⁶⁶

Sa i takon bashkëpunimit me ITShKSh-në gjatë kësaj dekade, të dyja institutet në vitin 2010 kanë organizuar punë kërkimore njëjavore, me ekipe të përbashkëta (folkloristë, etnologë dhe filologë) në terrenin e rrethinave të Kumanovës, kanë organizuar disa konferenca të përbashkëta, si dhe kanë pasur botime në revistat përkatëse ("Gjurmime albanologjike" dhe "Studime albanologjike") e këmbim të literaturës. Mirëpo, nuk ka pasur ndonjë botim të ndërsjellë të studimeve mes IA-së dhe ITShKSh-së e as shkëmbim të përvojave të studiuesve (ligjëruesve) ndërmjet dy institucioneve.

BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET E TJERA SHKENCORE, ARSIMORE DHE KULTURORE

IA nuk ka ndonjë bashkëpunim konkret me Fakultetin e Filologjisë të UP-së e as me atë të UT-së, përveçse studiuesit e IA-së marrin pjesë rregullisht në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, bashkorganizim ky i Fakultetit Filologjik të UP-së dhe i Fakultetit të Gjuhësisë-Historisë të Universitetit të Tiranës, si dhe ka raste të pjesëmarrjes së kolegëve nga Fakulteti Filologjik i UP-së në aktivitetet e IA-së, veçmas për të botuar në revistën "Gjurmime albanologjike".

Nga njësitë e tjera akademike të UP-së, IA ka bashkëpunim me Fakultetin Filozofik, me të cilin ka bashkorganizuar tri konferenca shkencore: të parën në vitin 2012 për "Mahmutbegollët në rrjedhat e historisë", të dytën më 2013 për nder të 50-vjetorit të themelimit të Organizatës "Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve", dhe të fundit kushtuar 20-vjetorit të çlirimit të Kosovës më 2019.

IA nuk ka ndonjë bashkëpunim me AShAK-un sa u përket projekteve, aktiviteteve dhe botimeve të përbashkëta (por ka këmbim të rregullt të botimeve). Në aktivitetet shkencore që organizon AShAK-u, studiuesit e IA-së marrin pjesë, ndërsa anëtarët e AShAK, me gjithë ftesat, nuk marrin pjesë në aktivitetet e IA-së.

Megjithatë, Instituti Albanologjik ka bashkëpunim me Institutin e Historisë. Meqë Instituti i Historisë merret vetëm me studime të fushës së historisë (duke filluar nga antikiteti e deri më sot), kurse Instituti Albanologjik ka për fushë të trajtimit gjithë albanologjinë, e në kuadër të vet ka një departament të historisë më një numër të kufizuar studiuesish, ka bashkëpunim mes këtyre dy instituteve. Por, sipas Sekretarit Shkencor të Institutit të Historisë, Gjon Berisha, ai ndoshta nuk është i nivelit më të mirë të mundshëm. Sipas tij, ky bashkëpunim është i përqendruar në:

- organizimin e përbashkët të aktiviteteve shkencore (tryeza shkencore, simpoziume, konferenca, etj.);
- botimet e përbashkëta (kryesisht punimet e konferencave të bashkorganizuara);
- pjesëmarrjen në projekte të përbashkëta ose të veçanta (për shembull në projektin 'Historia e Kosovës');
- angazhime në cilësinë e redaktorëve e recensentëve në botime të ndërsjella.

Berisha sqaron se punonjësit e të dy instituteve, në mënyrë të pavarur i dërgojnë dhe i botojnë punimet në revistat periodike të njëri-tjetrit, "Gjurmime albanologjike" dhe "Kosova".⁶⁷ Ai shton se viteve të fundit hetohet një rënie e interesimit nga studiuesit për të botuar në revista brenda vendit, si pasojë e rregulloreve të institucioneve universitare për avancimet e stafit, të cilat zakonisht kërkojnë që punimet të botohen në revista të quajtura me 'impact factor' dhe ISSN.

Në maj të vitit 2019, IA ka nënshkruar marrëveshje me IOM (International Organization for Migration) për kohë të pacaktuar për publikimin e fjalorit të parë shqip-serbisht në internet, si dhe për bashkëpunimin me palët me rëndësi për këtë fjalor, me qëllim të ngritjes së vetëdijes për përfitimet e dygjuhësisë, në bashkëpunim me organizata të komuniteteve dhe me organet shtetërore, por edhe për organizimin e takimeve, tryezave, punëtorive e të debateve të ndryshme.

BASHKËPUNIMI ME INSTITUTET E TJERA RAJONALE

Më 15 mars 2018, IA nënshkroi një Memorandum Bashkëpunimi me Institutin Shkencor Maqedonas në Sofje, i cili është shumë i ngjashëm me memorandumin e nënshkruar me ASA-n. Sipas këtij memorandumi, këto dy institute janë pajtuar:

- ta formojnë një Këshill Koordinues, i cili do ta hartojë strategjinë studimore dhe planin e përbashkët kërkimor-shkencor;
- të botojnë burime historike dhe punime të veçanta nga historia, gjuhësia, kultura, etnologjia, folklori;
- të organizojnë veprimtari shkencore (konferenca, simpoziume, ekspozita, filma dokumentarë),
- të këmbëjnë botime e materiale;

- të kenë bashkëpunim në kualifikimin e kuadrove; si dhe
- të kenë pjesëmarrje të ndërsjellë në redaksitë e revistave shkencore.⁶⁸

Lidhur me bashkëpunimin e mësipërm, nuk është formuar Këshilli Koordinues mes dy institutive, as nuk janë hartuar strategjia studimore a plani i përbashkët kërkimor-shkencor. Janë këmbyer revistat shkencore “Gjurmime albanologjike” dhe “Macedonian review”, por edhe botimet e veçanta, pastaj janë këmbyer anëtarët e redaksive përkatëse të organeve shkencore – një pjesëtar i Institutit Maqedonas të Sofjes është anëtar i redaksisë “Gjurmime albanologjike” dhe një pjesëtar i IA-së është anëtar i revistës “Macedonian review”. Nuk ka pasur ndonjë bashkëpunim lidhur me kualifikimin e kuadrove, por të dyja institutet janë në bisedime për përkthimin e dy veprave nga shqipja në bullgarisht dhe të një vepre nga bullgarishtja në shqip.

6. FINANCIMI DHE TRANSPARENCA

BUXHETI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Në periudhën 1967-1989, IA-ja financohej nga Buxheti i KSA të Kosovës, në vitet 1990-1999 nga ndihmat, në vitet 2000-2004 përmes Rektoratit të UP-së, e që prej vitit 2004 nëpërmjet MASHT-it. Aktualisht, IA-ja mund të financohet ligjërisht nga buxheti qendror, mjetet e fituara nga realizimi i projekteve shkencore dhe artistike, si dhe nga donacionet. Buxheti i IA-së mbushet nga buxheti qendror, kurse pjesa tjetër nga mjetet e fituara nga qiratë. Megjithëse botimet e IA-së janë në shitje nëpër librari të ndryshme, sipas zyrtarit financiar, ato nuk shiten por jepen falas.⁶⁹ Prej vitit 2012, kur u bë zë i veçantë buxhetor, e deri më 2019, sipas të dhënave nga tabelat e buxhetit të Republikës së Kosovës, IA ka marrë mbi 5 milionë euro.⁷⁰ Në dhjetë vjetët e fundit, buxheti i IA-së ka qenë mbi gjysmë milioni euro në vit dhe mbi 2/3 e buxhetit vjetor gjatë këtyre viteve janë shpenzuar për paga dhe mëditje.

Viti 2012	587,834 €
Viti 2013	574,824 €
Viti 2014	610,901 €
Viti 2015	740,888 €
Viti 2016	713,046 €
Viti 2017	746,518 €
Viti 2018	793,307 €
Viti 2019	919,518 €

GJITHSEJ: 5,686,838 €

QIRATË

Tri hapësira të objektit, Instituti Albanologjik që nga viti 2006, me vendim të KD-së, ua lëshon me qira tri bizneseve: 'ELC', 'Comtrade' dhe 'Artini'.⁷¹ Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) për MASHT në vitin 2012 ka konstatuar se «kontratat [me kompanitë qiramarrëse] nuk janë transparente, pasi që nuk shfrytëzohen procedurat tenderuese me rastin e dhënies në shfrytëzim». ⁷² Praktika që është ndjekur është vazhdimi i kontratave me kompanitë e njëjta, me çmime të njëjta për metër katror.⁷³ Herën e fundit kontratat janë rilidhur në vitin 2017 dhe kohëzgjatja e tyre është 5-vjeçare.⁷⁴

Njëri nga bizneset është N.Sh "ELC", në pronësinë e bashkëshortes së sekretarit të IA-së, Sylë Kasumajt.⁷⁵ Një biznes tjetër është "NTP Artini O.P.", pronarët e të cilit janë Zijavere

dhe Jahir Ahmeti, ky i fundit dikur punonjës shkencor në Institutin Albanologjik.⁷⁶ Sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, çdo udhëheqës institucional dhe çdo institucion «duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për t'i parandaluar dhe zgjidhur rastet e konfliktit të interesit».⁷⁷ Divizioni për Parandalimin e Konfliktit të Interesit (DPKI) në Agjencinë Kundër Korrupsionit (AKK) ka refuzuar të tregojë nëse ka raste të paraqitura për sekretarin dhe ish-punonjës të IA-së. AKK ka thënë se «shqyrton dhe trajton çdo informatë që ka të bëjë me konflikt të interesit, duke respektuar konfidencialitetin gjatë gjithë zhvillimit të procedurës deri në rezultatin përfundimtar, ashtu siç parashihet edhe në paragrafin 6 të Nenit 22 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit».⁷⁸

Ndërkaq, Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjigjur se nuk ka ligje a rregullore që e rregullojnë dhënien me qira të hapësirave të institucioneve qendrore. Megjithatë, ZKA ka rekomanduar se «si praktikë e mirë, dhe me qëllim të përfitimit të çmimit sa më të lartë, institucioni duhet të bëjë një shpallje ose ankand, ku të interesuarit për shfrytëzimin e objektit do të kishin mundësi të konkurronin mes vete».⁷⁹

Për hapësirat e dhëna me qira, Drejtori i IA-së, Hysen Matoshi, thotë se objekti i librisë i është dhënë me qira operatorit të tanishëm qysh më 1998, pra para luftës, ndërsa hapësirat e tjera asnjëherë nuk kanë qenë pjesë funksionale e IA-së, por kanë qenë nënkalime në shtylla, e që pas luftës, në kohën kur IA ka qenë nën menaxhimin e UP-së (pra nën menaxhim ndërkombëtar), nëpërmjet një thirrjeje publike, janë ofruar që të përdoren si lokale nga të interesuar për veprimtari, e që nuk e pengojnë punën e IA-së. Ndërkaq, sa i takon faktit se njëri nga bizneset është në pronësinë e bashkëshortes së sekretarit të IA-së, e tjetri në pronësi të një ish-punonjësi shkencor të IA-së, Matoshi thotë se këta persona nuk kanë qenë asnjëherë pjesë e organeve vendimmarrëse të IA-së, ku është vendosur në lidhje me kërkesën për marrje me qira, ose të UP-së si institucion menaxhues i objekteve publike të arsimit dhe të shkencës, e se asnjë kompani konkurruese nuk është vënë në pozitë të pabarabartë. Përveç këtyre, sipas Drejtorit Matoshi, as institucionet kompetente nuk kanë gjetur ndonjë konflikt interesi lidhur me këtë çështje.

DONACIONET DHE BURIMET E TJERA

IA ka marrë një donacion nga Ambasada e Norvegjisë në Prishtinë për financimin e revistës 'Gjurmime albanologjike' në gjuhën angleze, por në mungesë të një llogarie bankare të institutit, Ambasada e Norvegjisë kishte kërkuar që mjetet të derdreshin në llogarinë bankare të njërit prej anëtarëve të redaksisë, të autorizuar që t'i shpenzonte sipas planifikimeve. Donacione të tjera prej vitit 2008 e këndeje nuk ka pasur, por ka pasur financime nga institucionet e ndryshme të Kosovës për projekte të ndryshme,

jashtë buxhetit të IA-së, siç janë botimet e librave (p.sh.: Ministria e Arsimit, Ministria e Kulturës, Komuna e Prishtinës, Komuna e Obiliqit), si dhe grante të ndryshme të fituara nga punonjësit e IA-së prej MASHT-it për aktivitete të ndryshme.⁸⁰

Raportet vjetore (narrative dhe financiare) nuk janë publike. IA-ja nuk i publikon raportet financiare në faqen e vet zyrtare në internet, e as në faqen e MASHT-it.

7. RAPORTIMI DHE MONITORIMI

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË / QEVERIA E KOSOVËS

Ligji për Veprimtari Kërkimore Shkencore e obligon Qeverinë që të ndajë 0.7% të buxhetit vjetor për shkencë (për realizimin e projekteve shkencore, asistimin e punonjësve shkencorë në punën e tyre, realizimin e Programit Kombëtar të Shkencës, etj).⁸¹ Buxheti i vitit 2019 është rreth 2.3 miliardë euro,⁸² ndërkaq për hir të këtij ligji janë ndarë rreth 1 milionë euro. Kjo shifër është mbi 10 milionë euro më e ulët nga ajo që parashihet me ligj, sepse 0.7% e buxhetit të përgjithshëm prej 2.3 miliardë eurosh janë 16,1 milionë euro.

Përveç financimit, këshillat e nivelit të lartë ligjërish nuk kanë më mandate. Anëtarët e Këshillave Kërkimore-Shkencorë (KKSh) propozohen nga Qeveria dhe emërohen nga Kuvendi. Këshilli Kombëtar i Shkencës për herë të fundit është emëruar në vitin 2007, ndërsa mandati ligjor i tij është 4-vjeçar. Detyra kryesore e KKSh-së është që të nxjerrë Programin Kombëtar të Shkencës (që vlen 5 vjet). I vetmi Program Kombëtar i Shkencës është miratuar nga Kuvendi në vitin 2008. Situata është e njëjtë edhe me Këshillin Shkencor të MASHT-it. Ai është emëruar për herë të fundit në shkurt të vitit 2015 për një mandat 4-vjeçar.

KOMISIONI PARLAMENTAR PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI / KUVENDI I KOSOVËS

Komisioni Parlamentar për Arsim, Shkencë dhe Teknologji i Kuvendit të Kosovës, që nga shpallja e Pavarësisë së Kosovës më 2008 e deri më sot ka zhvilluar vetëm një takim informues me drejtuesit e IA-së. Pra, IA nuk ka raportuar asnjëherë në këtë komision për punën e vet.

8. RAPORTI ME PUBLIKUN

IA nuk ka Zyrë për Marrëdhënie me Publikun e as zëdhënës. Punonjësit e IA-së nuk kanë e-maile individuale të afishuara në uebfaqen zyrtare të institucionit. Faqja zyrtare në internet është e pastrukturuar, e papërditësuar dhe vetëm në gjuhën shqipe (nuk ka asgjë në gjuhën angleze, as në atë serbe).

Drejtori i IA-së thotë se ndonëse instituti nuk ka personel të veçantë për komunikim me publikun, këtë detyrë kryesisht e kryejnë drejtori, sekretari shkencor dhe shefat e degëve, si dhe ekspertët e fushave albanologjike, në varësi të interesimeve të publikut. Sipas tij, publiku i gjerë njoftohet lidhur me veprimtaritë dhe rezultatet e punonjësve të IA-së, ngase mediat ftohen në të gjitha aktivitetet e IA-së dhe për pjesën më të madhe të botimeve shkruhen e publikohen vlerësime në shtyp dhe në periodikun shkencor. Sa për faqen zyrtare në internet, Drejtori i IA-së thotë se vitin e kaluar kanë punësuar një punonjës të IT-së dhe kanë vendosur që ta ideojnë dhe ta krijojnë një faqe të re, ku të dhënat do të freskohen dhe faqja do të përditësohet rregullisht. Po ashtu, IA e ka caktuar si person përgjegjës për qasje në dokumente publike sekretarin Sylë Kasumaj.

GJETJET KRYESORE ME REKOMANDIME

Në mandatin e Institutit Albanologjik bien këto detyra:

- të realizojë projekte të ndryshme kërkimore-shkencore (monografi, revista shkencore, studime dhe punime të tjera në shqip ose në gjuhë të tjera nga fushat e albanologjisë);
- ta vjelë e ta përpunojë lëndën gjuhësore, letrare, folklorike, etnomuzikologjike, arkeologjike, historike, etnologjike, me vlerë për studimet albanologjike,
- ta publikojë punën e vet shkencore nëpërmjet botimeve periodike dhe veprave të veçanta;
- të botojë studime të autorëve shqiptarë dhe të huaj, që janë me interes për albanologjinë;
- të regjistrojë, të mbledhë dhe t'i studiojë gjetjet dhe monumentet kulturore, pastaj lëndën arkivore dhe dokumentare që i konsideron të vlefshme për punë kërkimore-shkencore dhe për kulturën e shqiptarëve në përgjithësi, t'i kërkojë dhe t'i ruajë ato nëse e sheh të nevojshme, sidomos kur janë të pambrojtura ose kur janë në kuadrin e institucioneve të tjera;
- të bashkëpunojë me institucione e individë që bëjnë punë të ngjashme brenda e jashtë vendit,
- të organizojë tribuna, tryeza, sesione, simpoziume, konferenca dhe kongrese shkencore, që kanë për qëllim të shtrojnë, të shtjellojnë e të zgjidhin probleme nga albanologjia;
- ta organizojë punën në bibliotekën e vet të specializuar, duke mbledhur edhe materiale të tjera, që ua ofron për shfrytëzim individëve dhe institucioneve të interesuara;
- ta organizojë punën në arkivin shkencor duke mbledhur e ruajtur materiale nga terreni; si dhe
- të zhvillojë forma të ndryshme të popullarizimit të punës së vet shkencore, duke organizuar dhe duke nxitur interesim për fushat që studion dhe për rezultatet e arritura.

IA realizon projekte të ndryshme kërkimore-shkencore dhe publikon punën e vet shkencore nëpërmjet botimeve periodike dhe veprave të veçanta – monografive, revistave shkencore, studimeve dhe punimeve të tjera – por vetëm në gjuhën shqipe dhe pa 'double blind peer review' (që d.m.th. se recensentët e punimit nuk duhet ta dinë identitetin e autorit dhe as autori identitetin e recensentëve). Po ashtu, IA boton studime të autorëve shqiptarë që janë me interes për albanologjinë, por deri më tani nuk e ka publikuar asnjë studim të ndonjë albanologu ndërkombëtar.

IA bashkëpunon me institucione e individë që bëjnë punë të ngjashme brenda e jashtë vendit, por përkundër memorandumeve dhe protokolleve të bashkëpunimit, nuk ka asnjë publikim të përbashkët, e për më shumë, rezultati i vetëm i memorandumeve dhe

protokolleve është pjesëmarrja e anëtarëve të instituteve respektive në publikimet ose konferencat/simpoziumet/tryezat/tubimet shkencore të njëri-tjetrit.

IA organizon edhe tribuna, tryeza, sesione, simpoziume, konferenca dhe kongrese shkencore, që kanë për qëllim të shtrojnë, të shtjellojnë e të zgjidhin probleme nga albanologjia, por në këto konferenca, simpoziume, tryeza e tubime shkencore shumica dërrmuese e pjesëmarrësve janë shqiptarë. Të gjitha publikimet nga këto konferenca, simpoziume, tryeza e tubime shkencore botohen vetëm në shqip dhe pa 'double blind peer review'.

Të gjitha projektet e IA-së janë projekte kombëtare, që do të thotë se IA nuk ka asnjë projekt ndërkombëtar. Sa mund të thuhet se IA zhvillon forma të ndryshme të popullarizimit të punës së vet shkencore, kur nuk ka Zyrë për Marrëdhënie me Publikun e as zëdhënës (edhe pse e kanë një zyrtar për qasje në dokumente publike) dhe mbi të gjitha, faqen zyrtare në internet e ka të pastrukturuar, të papërditësuar dhe vetëm në gjuhën shqipe, pa asgjë në gjuhën angleze.

1. Sipas Ligjit për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, Drejtori, përveç që e drejton Institutin Albanologjik, kryeson edhe Këshillin Drejtues dhe Këshillin Shkencor të tij. Për më shumë, nuk ka kurrfarë kufizimesh ligjore a statutare sa i përket numrit të mandateve që mund të mbajë.

Ligji për Veprimtari Kërkimore-Shkencore duhet të ndryshojë, të paktën në këto pika:

- o Drejtori i Institutit Albanologjik të mos jetë edhe kryesues i Këshillit Drejtues dhe i Këshillit Shkencor të institutit;
- o Drejtori i Institutit Albanologjik të mos e ushtrojë detyrën për më shumë se dy mandate.

Po ashtu, ky ligj duhet t'i përcaktojë qartë kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Drejtues dhe të Këshillit Shkencor.

2. Në periudhën 1967-2015 në fushat Histori, Folklor e Etnologji, si dhe Gjuhësi e Letërsi, IA ka botuar 334 botime të veçanta me 170 autorë gjithsej. Prej këtyre botimeve, 122 janë nga autorë burra, 20 nga gra dhe 36 nga grupe autorësh. Të gjitha janë botime të autorëve shqiptarë, të gjitha në gjuhën shqipe dhe të gjitha të botuara në Kosovë. IA ka vetëm një botim në gjuhën serbe në katër vëllime nga fillimi i viteve të 1970-ta prej një autori të huaj, dhe vetëm dy autorë të huaj të përkthyer nga anglishtja në gjuhën shqipe në vitet 2011 e 2012.

Në të gjitha seksionet, IA duhet të botojë vepra të veçanta edhe në gjuhë të huaja, e sidomos në atë angleze, meqë njëri nga qëllimet e këtij institucioni është

ndërkombëtarizimi i shkencës dhe i kulturës së Kosovës. Po ashtu, duhen botuar autorë të huaj dhe të mos dominojnë veprat e punonjësve të IA-së, që ka raste kur janë ribotime. IA duhet të ketë një plan strategjik dhe t'i përcaktojë kriteret për përzgjedhjen e temave e të veprave që botohen, si dhe t'i krijojë mekanizmat për matjen e ndikimit të botimeve të veta.

3. IA ka gjithsej tri revista në të cilat botojnë kryesisht vetë punonjësit e IA-së. Në «Gjurmime albanologjike» prej vitit 1967 deri në vitin 2012 kanë publikuar studime e artikuj gjithsej 490 autorë, prej të cilëve 400 shqiptarë e 90 të huaj, shumë prej të cilëve nga vendet përreth, që kanë botuar gjatë viteve të 1970-ta, por edhe albanologë e studiues të huaj që kanë botuar kryesisht në këto dy dekadat e fundit. Struktura gjinore e autorëve është 419 burra e 71 gra. Është për t'u nënvizuar se të gjitha punimet në këtë revistë janë në gjuhën shqipe, pa përmbledhje në anglisht. Revista ka gjithsej 48 numra. Numri i fundit është botuar në vitin 2018.

«Gjuha shqipe» ka të botuar gjithsej 74 numra. Të gjithë numrat janë në shqip, pa abstrakte në anglisht ose në ndonjë gjuhë tjetër. Janë gjithsej 836 publikime, prej të cilave 28 me autorë të huaj, të tjerat nga shqiptarë; 694 publikime janë prej autorëve burra e 142 të autoreve gra.

Në «Albanologji» publikohen punimet e autorëve që marrin pjesë në 'Java e Albanologjisë', e cila organizohet çdo vit që nga viti 2011. Deri më tani janë botuar gjithsej 16 numra. Numri i fundit është botuar më 2016. Nga 687 publikime në këtë revistë, 488 janë nga autorë burra, 199 janë nga gra, 678 janë publikime të autorëve shqiptarë, e vetëm 9 janë të autorëve të huaj. Po ashtu, të gjitha kontributet janë në gjuhën shqipe dhe nuk kanë përmbledhje të shkurtra në anglisht.

IA ka gjithsej tri revista në të cilat botojnë kryesisht punonjësit e IA-së. Revistat e IA-së duhet të botojnë sa më shumë publikime të autorëve shqiptarë në gjuhën angleze. Po ashtu, është mirë të botohen edhe autorë të huaj.

4. Mbi 90% të punimeve të botuara në të trija revistat e IA-së janë nga autorë shqiptarë dhe vetëm në gjuhën shqipe. Përgjegjësit e të gjitha revistave thonë se kanë 'double blind peer review', mirëpo ato nuk i përmbushin kriteret e kërkuara për një revistë me recensim të këtij lloji:

a) asnjëra prej këtyre revistave nuk figuron në databazat serioze ku indeksohen revistat me 'double blind peer review', si SCOPUS ose WOS, e as në ndonjë databazë tjetër serioze të fushës së ngushtë;

b) në asnjërin prej artikujve të këtyre revistave nuk figuron emri i redaktorit që e ka përcjellë procesin e vlerësimit të artikullit;

c) në asnjërin prej këtyre revistave nuk ka të dhëna për datën e dërgimit të punimit në revistë dhe datën e pranimit të punimit nga redaktori i revistës, në mënyrë që të dihet se sa kohë ka marrë publikimi i atij punimi.

Këto revista nuk kanë ISSN (kod të pranuar e të njohur ndërkombëtarisht për publikimet serike), që është kriter teknik për revista. Po ashtu, asnjëra prej këtyre pesë revistave nuk i ka numrat online e të qashtëm nga publiku, që po ashtu është kriter teknik për revistat.

Revistat e IA-së duhet të pajisen me kode ndërkombëtare; të publikohen online të gjithë numrat e revistave, dhe të kenë patjetër 'double blind peer review', si dhe të përmbajnë tekst edhe në gjuhën angleze, sepse kjo, ndër të tjera, e bën më të lehtë regjistrimin në databaza.

5. Në të gjitha konferencat, simpoziumet, tryezat e tubimet shkencore, të organizuara nga IA, shumica dërrmuese e pjesëmarrësve janë shqiptarë. Të gjitha publikimet nga këto konferenca, simpoziume, tryeza e tubime shkencore botohen vetëm në shqip dhe pa 'double blind peer review'.

Në konferencat, simpoziumet, tryezat e tubimet shkencore të IA-së duhet të ketë edhe autorë të huaj dhe të gjitha publikimet nga këto konferenca, simpoziume, tryeza e tubime shkencore të botohen edhe në anglisht dhe të kenë 'double blind peer review'.

6. Që nga viti 2008, kur IA është ndarë si linjë e veçantë buxhetore, e sidomos prej vitit 2012, kur buxhetin vjetor e ka mbi gjysmë milioni euro (buxheti për sivjet është gati një milion euro), prej dy projekteve të mëdha ka finalizuar vetëm «Vepra e Rexhep Qosjes». Projektin «Vepra e Anton Çettës», që është dashur ta përfundonte para dy vjetësh, nuk e ka përfunduar ende.

Duhet sqaruar se cila është vlera shkencore e veprës së Rexhep Qosjes dhe e veprës së Anton Çettës. Po ashtu, duhet sqaruar se pse është e nevojshme të botohen komplet veprat e këtyre dy ish-punonjësve të IA-së, e pse jo (edhe) veprat e të tjerëve. IA duhet të ketë kritere të përcaktuara qartë për botimin e completeve të veprave të punëtorëve e ish punëtorëve shkencorë të IA-së.

7. Të gjitha projektet e IA-së janë projekte kombëtare. IA nuk ka asnjë projekt ndërkombëtar. IA duhet të angazhohet edhe për projekte ndërkombëtar.

8. Nga 36 punonjës të rregullt të IA-së, 31 sosh i kanë përfunduar studimet e nivelit BA në Universitetin e Prishtinës, tre në Universitetin e Zagrebit, një në Universitetin e Tiranës dhe një në Universitetin e Shkupit. Nivelin MA, 28 punonjës e kanë përfunduar në Prishtinë, gjashtë në Tiranë, një në Zagreb, një në Lumiere Lyon. Nga 25 punonjës me PhD, 12 e kanë kryer në Prishtinë, tetë në Tiranë, një në Tetovë, një në Shkup, një në Zagreb dhe një në Vjenë. Në përgjithësi, nga 36 punonjës të IA-së, 31 sosh i kanë të gjitha nivelet e studimeve të përfunduara nëpër universitetet shqiptare, e vetëm pesë e kanë përfunduar të paktën një nivel në universitete në gjuhë të huaja.

Nga 36 punonjës të rregullt të IA-së, 31 i kanë të gjitha nivelet e studimeve të përfunduara nëpër universitetet në gjuhën shqipe, e vetëm pesë e kanë përfunduar të paktën një nivel në universitete në gjuhë të huaja. Do të ishte mirë që IA të hapej edhe për ata që kanë kryer studimet BA, MA dhe PhD në universitete në gjuhë të huaja.

9. Prej vitit 2012 kur u bë zë i veçantë buxhetor, e deri më 2019, sipas të dhënave të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës, IA ka marrë nga Buxheti i Republikës së Kosovës mbi 5 milionë euro. Rreth 2/3 e tij janë ndarë për paga dhe mëditje.

Buxheti duhet të riformulohet, duke u ridrejtuar për shkencë, e jo për paga, që do të thotë se duhet të përdoret mekanizimi 'research based', i cili nënkupton që pagat për punonjësit e IA-së të jenë të bazuara në punimet e tyre shkencore. Përveçse nga buxheti i Kosovës, IA duhet të kërkojë donacione edhe nga jashtë, e për këtë duhet që IA të hapë llogari bankare sa më parë. Është absurde që IA deri më tani nuk ka llogari të veten bankare dhe për rrjedhojë është detyruar që mjetet e një donacioni nga Ambasada e Norvegjisë t'i pranojë në llogarinë bankare private të një zyrtari të vet. Po ashtu, IA duhet të jetë transparente edhe në pasqyrën e shpenzimeve.

10. Në bazë të Ligjit për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, për titullin bashkëpunëtor shkencor kërkohet së paku një punim shkencor, në ndonjë revistë relevante ndërkombëtare në kuadër të fushës; për bashkëpunëtor të lartë shkencor kërkohen së paku tri punime shkencore në revistat relevante ndërkombëtare në kuadër të fushës; për këshilltar shkencor kërkohen së paku pesë punime shkencore në revistat relevante ndërkombëtare në kuadër të fushës. Pagat mujore janë si vijon: bashkëpunëtor shkencor 1239 euro; bashkëpunëtor i lartë shkencor 1379 euro; këshilltar shkencor 1622 euro.

11. Nga 36 punonjës shkencorë të IA-së, shumica dërrmuese e tyre (31) i kanë të publikuara CV-të e veta në faqen e internetit të IA-së, por nuk i kanë të përditësuara me publikimet nëpër revistat akademike vendore e ndërkombëtare. Pasi IA na i ofroi CV-të e përditësuara të 36 punonjësve shkencorë të IA-së, kërkuam në platformat 'Scopus' dhe 'Web of Science' për të parë nëse kanë publikime nëpër revista akademike ndërkombëtare. Nga kërkimi i titujve të punimeve, numrave të ISSN-së dhe emrave të publikuesve në të dyja platformat, rezultoi se prej 36 punonjësve të IA-së, asnjëri nuk ka punime të publikuara në revista akademike ndërkombëtare të listuara në këto platforma.

12. Punonjësit shkencorë të IA-së, ndonëse nuk kanë punime të publikuara në revista akademike ndërkombëtare të listuara në platformat 'Scopus' dhe 'Web of Science', paguhen sikur të kishin publikime në to. Për përzgjedhjen e punonjësve shkencorë të IA-së duhet respektohet Ligji për Veprimtari Kërkimore-Shkencore: për

bashkëpunëtorë shkencorë të kërkohet së paku një punim shkencor, në ndonjë revistë relevante ndërkombëtare në kuadër të lëmit; për bashkëpunëtorë të lartë shkencorë të kërkohen së paku tri punime shkencore në revistat relevante ndërkombëtare në kuadër të lëmit; për këshilltarë shkencorë të kërkohen së paku pesë punime shkencore në revistat relevante ndërkombëtare në kuadër të lëmit. Po ashtu, IA në faqen e vet zyrtare të internetit duhet ta ketë një platformë ku i publikon të gjitha botimet e veta, si dhe të nxisë sa më shumë kritika, recensione e polemika për to.

13. Sa i takon kriterit gjinor, nga 36 punonjës shkencorë, 25 janë burra e 11 gra, ndërkaq nga stafi administrativ, katër janë burra e katër gra. Lidhur me përfshirjen etnike, prej 36 punonjësve, që të gjithë janë shqiptarë. Që nga viti 1990 e këndeje në IA nuk është punësuar asnjë pjesëtar i komuniteteve të tjera etnike në Kosovë.

Të gjithë punonjësit e IA-së janë shqiptarë. Që nga viti 1990 e këndeje në IA nuk është punësuar asnjë pjesëtar i komuniteteve etnike minoritare në Kosovë. Do të ishte e këshillueshme që të ketë edhe pjesëtarë të komuniteteve etnike minoritare në Kosovë.

14. Nga 36 punonjës të IA-së, dy kanë qenë të përfshirë në garën zgjedhore, njëri në vitin 2007 dhe tjetri në vitin 2017. Në Këshillin Drejtues të IA-së, njëri nga dy anëtarët e caktuar nga MASHT-i, Ismail Syla, është këshilltar politik i Presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi.

15. IA ka memorandume dhe protokolle të bashkëpunimit me ASA-n, por nuk ka asnjë publikim të përbashkët me këtë institucion. Rezultati i vetëm i memorandumeve dhe protokolleve është pjesëmarrja e anëtarëve të instituteve respektive në publikimet ose konferencat/simpoziumet/ tryezat/tubimet shkencore të njëri-tjetrit. Po ashtu, prej gjithë atyre marrëveshjeve të nënshkuara me institute dhe asociacione shkencore në Shqipëri, Maqedoni e Bullgari, rezultati deri më sot është pjesëmarrja e anëtarëve të instituteve nënshkruese në publikimet ose konferencat/simpoziumet/tryezat/tubimet shkencore të njëri-tjetrit. IA duhet t'i jetësojë marrëveshjet, protokollat e memorandumet e nënshkuara me institutet e asociacionet e tjera shkencore.

16. IA nuk ka asnjë projekt të përbashkët me institucionet e tjera shkencore, si: Instituti i Arkeologjisë, Instituti i Historisë, AShAK-u, UP-ja, etj. Do të ishte e udhës që në projektet e IA-së të përfshiheshin edhe këto institucione, në mënyrë që, veç të tjerash, punët e IA-së të mos përsëriteshin nga punët e institucioneve të tjera.

17. Raportet vjetore (narrative dhe financiare) nuk janë publike. IA-ja nuk i publikon raportet financiare në faqen e vet zyrtare të internetit e as në faqen e MASHT-it.

18. Tri hapësira të objektit të vet, IA, me vendim të KD-së, ua lëshon me qira

tri bizneseve që nga viti 2006, prej të cilave aktualisht merr rreth 50 mijë euro. Njëri nga bizneset është në pronësinë e bashkëshortes së sekretarit të IA, e tjetri është në pronësinë e një ish-punonjësi shkencor të Institutit Albanologjik. Për më shumë, Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) për MASHT-in në vitin 2012 kishte konstatuar se «kontratat [me kompanitë qiramarrëse] nuk kanë qenë transparente pasi që nuk janë shfrytëzuar procedurat tenderuese me rastin e dhënies në shfrytëzim».

IA duhet të jetë transparente në këtë proces, të sigurojë kushte për konkurrencë të barabartë dhe t'i bëjë publike të hyrat nga qiraja. Po ashtu, meqë është MASHT-i ai që i merr paratë nga këto qira, duhet t'i zhvillojë procedurat e prokurimit për përzgjedhjen e shfrytëzuesve me qira të hapësirave të IA-së.

19. IA i raporton MASHT-it, mirëpo nuk i ka raportuar asnjëherë Komisionit Parlamentar për Arsim, Shkencë dhe Teknologji të Kuvendit të Kosovës. Ky komision deri më sot ka zhvilluar vetëm një takim informues me drejtuesit e IA-së, madje ky është realizuar gjatë kohës sa po zhvillohej hulumtimi për këtë raport.

IA duhet të raportojë për punën e vet të paktën një herë në vit në Komisionin Parlamentar për Arsim, Shkencë dhe Teknologji të Kuvendit të Kosovës. Kur të hartohet ligji i ri për IA-në, do të ishte e udhës që të përfshihej në të dispozita e cila përcakton se IA duhet të raportojë një herë në vit në Komisionin Parlamentar për Arsim, Shkencë dhe Teknologji të Kuvendit të Kosovës. Po ashtu, do të ishte e udhës që të publikoheshin të gjitha dokumentet që lidhen me financimin e IA-së.

20. IA nuk ka Zyrë për Marrëdhënie me Publikun e as zëdhënës. Faqja zyrtare në internet e IA-së është e pastrukturuar, e papërditësuar dhe vetëm në gjuhën shqipe (nuk ka asgjë në gjuhën angleze e serbe). Sekretari i IA-së është zyrtar edhe për qasje në dokumente publike.

IA duhet ta krijojë një Zyrë për Marrëdhënie me Publikun dhe ta emërojë një zëdhënës. Faqja zyrtare në internet e IA-së duhet të strukturohet, të përditësohet dhe të jetë e disponueshme edhe në gjuhën angleze. Gjithashtu, do të ishte e pëlqyeshme që edhe mediat (gazetat, radiot, televizionet dhe portalet), pastaj sektori joqeveritar, por edhe segmente të tjera të shoqërisë civile, të ishin më aktive lidhur me (mos) punën e IA-së.

BIBLIOGRAFIA

LEGJISLACIONI, VENDIMET DHE MARRËVESHJET

- Službeni List Autonomne Oblasti Kosova i Metohije, Broj 8, 15 Avgust 1953, Prishtina.
- Ligji Nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore Shkencore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.11, 2 maj 2013
- Ligji Nr. 06/L -011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 5, 27 prill 2018
- Ligji 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 88, 25 nëntor 2010
- Ligji 06/L -133 mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2019, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.4,14 shkurt 2019

- Statuti i Institutit Albanologjik, 27 prill 2015, kopje fizike marrë nga IA më 22 prill 2018,
- Rregullorja e Punës së Këshillit Drejtues të Institutit Albanologjik, 1 korrik 2015, kopje fizike marrë nga IA më 22 prill 2018
- Marrëveshja për Arsim Rugova-Milošević:
http://archive.santegidio.org/archivio/pace/kosovo_19960109_EN.htm
- Memorandum Bashkëpunimi mes Institutit Albanologjik dhe Akademisë së Studimeve Albanologjike, 7 qershor 2018, Tiranë.
- Marrëveshje Bashkëpunimi mes Institutit Albanologjik dhe Institutit për Trashëgiminë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve (ITShKSh), 24 shkurt 2009, Shkup.
- Memorandum Bashkëpunimi mes Institutit Albanologjik dhe Institutit Shkencor Maqedonas, 15 mars 2018, Sofje

DOKUMENTE

- Zyra Kombëtare e Auditorit, «RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË MINISTRISË SË ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2012», maj 2013
- Tabelat e Buxhetit të Republikës së Kosovës nga 2012 deri më 2019, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës
- CV-të e punonjësve shencorë të Institutit Albanologjik, të dërguara më 2 maj përmes postës elektronike
- Regjistri i punonjësve më datën 15 prill 2019, dërguar përmes postës elektronike po atë ditë
- Organogrami i IA-së, i dërguar më 15 prill 2019
- Raport Financiar mbi Projektin e Ambasadës Norvegjeze, 15 prill 2015, dërguar përmes postës elektronike më 23 maj 2015

LIBRA

- «Tridhjetë vjet të Institutit Albanologjik (1967-1997)», Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1997
- Robert Elsie «Historical Dictionary of Kosovo», Scarecrow Press, Plymouth, Mbretëri e Bashkuar, 2010, faqe 26.
- «Fjalori Enciklopedik i Kosovës I – A-K», Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2018
- «Njëzet vjet të Institutit Albanologjik (1967-1987)», Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1987, faqe 185-186.
- «Tridhjetë vjet të Institutit Albanologjik (1967-1997)», Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1997, faqe 66.
- «Fjalori Enciklopedik i Kosovës I – A-K», Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2018, faqe 675.
- Nataša Kandić «Nën Lupë - Të Drejtat e Njeriut në Kosovë», Fondi për të Drejtën Humanitare, Beograd, 1998
- Emine Fetahu-Abdixhiku, Bibliografia e Botimeve të Veçanta të Institutit Albanologjik të Prishtinës – 1953-2003, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2004
- Emine Fetahu-Abdixhiku, Bibliografia e Botimeve të Veçanta të Institutit Albanologjik– 2004-2015, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2018
- Emine Fetahu-Abdixhiku, 50 Vjet Gjurmime Albanologjike– 1962-2012, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2014
- Ilir Gjinolli dhe Lulzim Kabashi «Modernizmi Kosovar: një abetare e arkitekturës», Galeria Kombëtare e Kosovës, Prishtinë, 2015

REVISTA

- Revista «Gjurmime Albanologjike», Instituti Albanologjik, numrat 1-48, 1968-2016, Prishtinë
- Revista «Gjuha Shqipe», Instituti Albanologjik, numrat 1-74, 1982-2016, Prishtinë
- Revista «Albanologji», Instituti Albanologjik, numrat 1-16, 2011-2016, Prishtinë.

TË TJERA

Robert Elsie «Historical Dictionary of Kosovo», Scarecrow Press, Plymouth, Mbretëri e Bashkuar, 2010, faqe 26.

[1] Kategoria «Historiku» në faqen zyrtare të IA. Mund të gjendet në:

- <http://www.instituti.albanologjik.com/index.aspx?SID=3&LID=2&AID=1&Ctype=1&CatID=1>

- "What Is an ISSN?" International Identifiers for Serials and Other Continuing Resources, in the Electronic and Print World, International Serial Standard Number International Centre, www.issn.org/understanding-the-issn/what-is-an-issn/.

- Elsevier. "What Is Peer Review?" 10th Edition, Mosby, www.elsevier.com/reviewers/what-is-peer-review.

- Të dhënat e "ELC" në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës:

<https://arbk.rks-gov.net/page.aspx?id=1,38,50900>

- Të dhënat e "NTP Artini O.P" në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës:

<https://arbk.rks-gov.net/page.aspx?id=1,38,49684>

-
- ¹ Në vitet '50 emërtimi zyrtar për Kosovën ka qenë "Kosova e Metohija". Ky emërtim është hequr në fund të viteve '60 dhe është kthyer në fillim të viteve '90 nga regjimi i Slobodan Milšević-it.
- ² Në ligj përdoret termi pezhorativ 'šiptarski'.
- ³ Službeni List Autonomne Oblasti Kosova i Metohije, Broj 8, 15 Avgust 1953, Priština.
- ⁴ «Tridhjetë vjet të Institutit Albanologjik (1967-1997)», Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1997, faqe 13-14.
- ⁵ Po aty, faqe 14.
- ⁶ Robert Elsie «Historical Dictionary of Kosovo», Scarecrow Press, Plymouth, Mbretëri e Bashkuar, 2010, faqe 26.
- ⁷ Kategoria «Historiku» në faqen zyrtare të IA. Mund të gjendet në:
<http://www.instituti.albanologjik.com/index.aspx?SID=3&LID=2&AID=1&Ctype=1&ACatID=1>
- ⁸ Ilir Gjinolli dhe Lulzim Kabashi «Modernizmi Kosovar: një abetare e arkitekturës», Galeria Kom-bëtare e Kosovës, Prishtinë, 2015, faqe 90.
- ⁹ Kategoria «Historiku» në faqen zyrtare të IA.
- ¹⁰ «Njëzet vjet të Institutit Albanologjik (1967-1987)», Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1987, faqe 185-186.
- ¹¹ «Tridhjetë vjet të Institutit Albanologjik (1967-1997)», Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1997, faqe 66.
- ¹² Kategoria «Historiku» në faqen zyrtare të IA-së.
- ¹³ «Fjalori Enciklopedik i Kosovës I – A-K», Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2018, faqe 675.
- ¹⁴ Kategoria «Historiku» në faqen zyrtare të IA-së.
- ¹⁵ Intervistë me Sadri Fetiun, drejtor i IA në periudhën 1991-2007, Prishtinë, 4 prill 2019.
- ¹⁶ Nataša Kandić «Nën Lupë - Të Drejtat e Njeriut në Kosovë», Fondi për të Drejtën Humanitare, Beograd, 1998, faqe 29.
- ¹⁷ Intervistë me Sadri Fetiun, drejtor i IA në periudhën 1991-2007, Prishtinë, 4 prill 2019.
- ¹⁸ Po aty.
- ¹⁹ Marrëveshja për Arsim Rugova-Milošević mund të gjendet në:
http://archive.santegidio.org/archivio/pace/kosovo_19960109_EN.htm
- ²⁰ <http://www.instituti.albanologjik.com/index.aspx?SID=3&LID=2&AID=1&Ctype=1&ACatID=1>
- ²¹ Ligji Nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore Shkencore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.11, 2 maj 2013, neni 7, pika 2.
- ²² Po aty, neni 14.
- ²³ Statuti i Institutit Albanologjik, 27 prill 2015, Prishtinë.
- ²⁴ Kategoria "Struktura Organizative" në faqen e IA:
<http://www.instituti.albanologjik.com/index.aspx?SID=11&LID=2&AID=1&Ctype=1&ACatID=1>
- ²⁵ Statuti i Institutit Albanologjik, faqe 5, neni 7, pika 2, kopje fizike marrë nga IA më 22 prill 2018, data e hyrjes në fuqi: 27 prill 2015.
- ²⁶ Regjistri i punonjësve të Institutit Albanologjik, dërguar përmes postës elektronike më 15 prill 2019.
- ²⁷ Po aty.
- ²⁸ Statuti i Institutit Albanologjik, 28 mars 2013, neni 23, pikat 1-5. Rregullorja e Punës së Këshillit Drejtues të Institutit Albanologjik, 1 korrik 2015, neni 2, pikat 1-3.
- ²⁹ Faqja e Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, Kategoria "Ekipi i Presidentit", nënkat-

-
- egoria "Këshillëtarët Politikë": <https://www.president-ksgov.net/sq/keshilltaret-politik>
- ³⁰ Faqja RTK Live, Kategoria "Bordi i RTK-së": <https://www.rtklive.com/sq/page.php?ID=7>
- ³¹ Organogrami i IA, dërguar më 15 prill 2019
- ³² Statuti i Institutit Albanologjik, 28 mars 2013, neni 23, pika 7.
- ³³ Po aty, neni 23, pika 7.5 dhe 7.6.
- ³⁴ Po aty, neni 23, pika 7.7, 7.8 dhe 7.9.
- ³⁵ Po aty, neni 23, pika 5.
- ³⁶ Po aty, neni 25, pika 1.
- ³⁷ Po aty, neni 25, pika 3.
- ³⁸ Po aty, neni 25, pika 2.4 dhe 2.5.
- ³⁹ Ligji Nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore Shkencore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.11, 2 maj 2013, faqe 10, neni 24, pika 1, Prishtinë
- ⁴⁰ Statuti i IA, faqe 15 dhe 16, neni 25, pika 1 dhe 2
- ⁴¹ Po aty, faqe 11, neni 26 dhe 27
- ⁴² Po aty, faqe 10, neni 23, pika 2
- ⁴³ Po aty, faqe 11, neni 26, pika 1.2
- ⁴⁴ Statistika të nxjerra nga: Emine Fetahu-Abdixhiku, Bibliografia e Botimeve të Veçanta të Institutit Albanologjik të Prishtinës – 1953-2003, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2004
- ⁴⁵ Statistika të nxjerra nga: Emine Fetahu-Abdixhiku, Bibliografia e Botimeve të Veçanta të Institutit Albanologjik– 2004-2015, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2018
- ⁴⁶ Revista «Gjurmime Albanologjike», Instituti Albanologjik, numrat 1-48, 1968-2016, Prishtinë.
- ⁴⁷ Revista «Gjuha Shqipe», Instituti Albanologjik, numrat 1-74, 1982-2016, Prishtinë. Dorianaxhari «Bibliografia e revistës 'Gjuha Shqipe' 1982-2015», Instituti Albanologjik, Prishtinë.
- ⁴⁸ Revista «Albanologji», Instituti Albanologjik, numrat 1-16, 2011-2016, Prishtinë.
- ⁴⁹ "What Is an ISSN?" International Identifiers for Serials and Other Continuing Resources, in the Electronic and Print World, International Serial Standard Number International Centre, www.issn.org/understanding-the-issn/what-is-an-issn/.
- ⁵⁰ Elsevier, "What Is Peer Review?" 10th Edition, Mosby, www.elsevier.com/reviewers/what-is-peer-review.
- ⁵¹ Intervistë me Lulëzim Lajçin, sekretar shkencor i Institutit Albanologjik.
- ⁵² Intervistë me Leontina Gega-Musën, udhëheqëse e degës së folklorit në Institutin Albanologjik, Prishtinë, 8 maj 2019.
- ⁵³ Intervistë me Lulëzim Lajçin, sekretar shkencor i Institutit Albanologjik, Prishtinë, 27 maj 2019.
- ⁵⁴ Intervistë me Lulëzim Lajçin, sekretar shkencor i Institutit Albanologjik, Prishtinë, 27 maj 2019.
- ⁵⁵ CV-të e punonjësve shkencorë të Institutit Albanologjik, të dërguara më 2 maj 2019 përmes postës elektronike.
- ⁵⁶ Ligji Nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore Shkencore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.11, 2 maj 2013, faqe 13, neni 34, Prishtinë.
- ⁵⁷ Po aty faqe 12-13, neni 33.
- ⁵⁸ Ligji Nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore Shkencore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.11, 2 maj 2013, faqe 12, neni 31 dhe 32, Prishtinë.
- ⁵⁹ Ligji nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.7, 1 mars 2019, faqe 23, Shtojca nr. 1, Prishtinë.
- ⁶⁰ CV-të e punonjësve shencorë të Institutit Albanologjik, të dërguara më 2 maj 2019 përmes

postës elektronike.

⁶¹ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Listat e Kandidatëve të Subjekteve Politike, Zgjedhjet për Kuvendin Komunal 2007 – Istog, faqe 3: http://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2018/04/CandidatesBooklet_06-Istog.pdf

⁶² Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Zgjedhjet për Kuvendin Komunal 2017 – Komuna: Pejë, [Broshurë e kandidatëve], faqe 1: http://kqz-ks.org/wp-content/uploads/2018/02/17_343_Broshura_Peje.pdf

⁶³ Faqja e Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, Kategoria “Ekipi i Presidentit”, Nënkatëgoria “Këshillëtarët Politikë”: <https://www.president-ks.gov.net/sq/keshilltaret-politik>

⁶⁴ Memorandum Bashkëpunimi mes Institutit Albanologjik dhe Akademisë së Studimeve Albanologjike, 7 qershor 2018, Tiranë.

⁶⁵ Përgjigje e Drejtorit të IA-së, Hysen Matoshit, 30 maj 2019, Prishtinë.

⁶⁶ Marrëveshje Bashkëpunimi mes Institutit Albanologjik dhe Institutit për Trashëgiminë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve (ITShKSh), 24 shkurt 2009, Shkup.

⁶⁷ Intervistë me Gjon Berishën, Sekretar Shkencor i Institutit të Historisë, 27 maj 2019, Prishtinë.

⁶⁸ Memorandum Bashkëpunimi mes Institutit Albanologjik dhe Institutit Shkencor Maqedonas, 15 mars 2018, Sofje.

⁶⁹ Intervistë me Sebush Dërmakun, përgjegjës financiar i Institutit Albanologjik, Prishtinë, 13 maj 2019.

⁷⁰ Tabelat e Buxhetit të Republikës së Kosovës nga 2012 deri në 2019, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës

⁷¹ Po aty.

⁷² Zyra Kombëtare të Auditorit, «RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË MINISTRISË SË ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2012», Maj 2013: http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2018/06/RaportiAuditimit_MASHT_2017_Shqip-1.pdf

⁷³ Intervistë me Sebush Dërmakun, përgjegjës financiar i Institutit Albanologjik, Prishtinë, 13 maj 2019.

⁷⁴ Kontratat me qiramarrësit në të cilat është siguruar qasje gjatë intervistës me Sebush Dërmakun

⁷⁵ Të dhënat e “ELC” në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës:

<https://arbkrks.gov.net/page.aspx?id=1,38,50900>

⁷⁶ Të dhënat e “NTP Artini O.P” në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës:

<https://arbkrks.gov.net/page.aspx?id=1,38,49684>

⁷⁷ Ligji nr. 06/L -011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.5, faqe 56, neni 8, pika 3, 27 prill 2018, Prishtinë.

⁷⁸ Përgjigje e Departamentit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit (AKK) përmes postës elektronike, 24 maj 2019.

⁷⁹ Përgjigje nga shefja e kabinetit të Auditorit të Përgjithshëm, Qëndresa Mulaj, 8 maj 2019.

⁸⁰ Përgjigje përmes postës elektronike, nga sekretari i IA, Sylë Kasumaj, 16 maj 2019.

⁸¹ Ligji Nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore Shkencore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.11, 2 maj 2013, faqe 3-4, neni 5, Prishtinë.

⁸² Ligji 06/L -133 mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2019, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.4, Tabela 2 Përmbledhje e ndarjeve buxhetore, 14 shkurt 2019.

